

Interpretimi 9 i KIRFN

Rivlerësimi i Instrumentave Derivative të Përfshirë

Referencat

- SNK 39 *Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja*
- SNRF 1 *Adoptimi për Herë të Parë i Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar*
- SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit*

Informacione bazë

- 1 Paragrafi 10 i SNK 39 e përshkruan derivativin e përfshirë si ‘përbërës të një instrumenti hibrid (të kombinuar) që mund të përfshijë edhe një kontratë bazë jo derivative—me efektin që disa flukse të mjeteve monetare të instrumentit të kombinuar ndryshojnë në një mënyrë të ngjashme me një derivativ të veçuar.’
- 2 Paragrafi 11 i SNK 39 kërkon që derivativi i përfshirë të ndahet nga kontrata bazë, dhe të cilësohet si derivativ në qoftë se dhe vetëm në qoftëse:
 - (a) karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e derivativëve të përfshirë nuk janë të lidhura ngushtë me karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e kontratës bazë;
 - (b) një instrument i veçantë me terma të njëjta me derivativin e përfshirë do të plotësonte përkufizimin e derivativit; dhe
 - (c) instrumenti hibrid (i kombinuar) nuk matet me vlerën e drejtë me ndryshimet në vlerën e drejtë që njihen tek fitimet apo humbjet (d.m.th. një derivativ i përfshirë në aktivin apo pasivin financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes nuk ndahet).

Objekti

- 3 Subjekt i paragrafëve 4 dhe 5 më poshtë, ky Interpretim gjen zbatim tek të gjithë derivativët e përfshirë brenda objektit të SNK 39.
- 4 Ky Interpretim nuk lidhet me çështjet e rimatjes që rrjedhin prej rivlerësimit të derivativëve të përfshirë.
- 5 Ky Interpretim nuk lidhet me blerjen e kontratave me derivativë të përfshirë në një kombinim biznesi, dhe as me rivlerësimin e mundshëm të tyre në datën e blerjes.

Çështje

- 6 SNK 39 kërkon që një njësi ekonomike, në momentin kur ajo bëhet palë në kontratë për herë të parë, të vlerësojë nëse është kërkuar që derivativët e përfshirë që përmbahen në kontratë të mbahen veças nga kontrata bazë, dhe të kontabilizohen si derivativë sipas këtij Standardi. Ky interpretim adreson problemet e mëposhtme:
 - (a) A e kërkon SNK 39 që ky vlerësim të bëhet vetëm kur njësi ekonomike bëhet palë e kontratës për herë të parë, apo vlerësimi duhet rishqyrtuar gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës?
 - (b) A duhet që adoptuesi për herë të parë të bëjë vlerësimin e tij bazuar në kushtet që ekzistojnë kur njësi ekonomike u bë palë kontrate për herë të parë, apo në kushtet që ishin mbizotëruese në çastin kur njësi ekonomike zbaton SNRF-të për herë të parë?

Konsensusi

- 7 Një njësi ekonomike përcakton nëse derivativi i përfshirë duhet të jetë detyrimisht i ndarë nga kontrata bazë, dhe nëse duhet kontabilizuar si derivativ, kur njësi ekonomike bëhet palë kontrate për herë të parë. Ndalohen rivlerësimet e mëvonshme, përveç rasteve kur ka ndryshim të termave të kontratës të cilat modifikojnë bindshëm fluksin e mjeteve monetare. Në rastin kur kontrata parashikon fluks monetar të ndryshëm, kërkohet rivlerësim. Njësi ekonomike përcakton nëse modifikimi i fluksit të mjeteve monetare është domethënës duke shqyrtuar

nivelin e fluksit të mjeteve monetare të parashikuara në të ardhmen të lidhura me derivativët e përfshirë, kontratën bazë apo nëse që të dyja kanë ndryshuar, dhe nëse ky ndryshim është domethënës në krahasim me parashikimet e mëparshme sipas kontratës së fluksit të mjeteve monetare.

- 8 Një adoptues për herë të parë vlerëson nëse derivativi i përfshirë duhet ndarë nga kontrata bazë dhe të kontabilizohet si derivativ sipas kushteve ekzistuese në datën më të fundit kur ajo bëhet palë kontrate për herë të parë, dhe datës kur rivlerësimi kërkohet nga paragrafi 7.

Data e hyrjes në fuqi dhe tranzicioni

- 9 Njësia ekonomike zbaton këtë interpretim për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 Qershor 2006, ose pas kësaj date. Inkurajohet zbatimi i më hershëm. Nëse njësia ekonomike zbaton këtë Interpretim në një periudhë përpara datës 1 Qershor 2006, ky fakt duhet të shoqërohet me dhënien e informacioneve shpjeguese. Interpretimi zbatohet në mënyrë prapaveruese.